# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5631
E shtunë, 17 nëntor 2018
çmimi 0.40 €

## Gramoz Ruçi u bënë thirrje vendeve që s'e kanë njohur Kosovën, ta njohin

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de



FLET PËR "EPOKËN E RE", VALDRIN LLUKA FAQE 4-5

# Deri në përfundim të mandatit ndërmarrjet publike do të jenë të vetëqëndrueshme

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka bërë me dije se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve publike qendrore kanë rritje të hyrash financiare për vitin 2017. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se që nga marrja e mandatit të tij të ministrit ridefinimi i objektivave dhe marrja e masave korrigjuese në disa ndërmarrje ka prodhuar rezultate fillestare. Lluka ka thënë se disa prej masave të para që janë ndërmarrë janë ndërprerja e shpenzimeve të panevojshme dhe shpërndarja e bonuseve tek anëtarët e bordit dhe punëtorët. "Jam optimist se deri në përfundim të mandatit katërvjeçar ndërmarrjet publike do të jenë të vetëqëndrueshme", ka thënë Lluka. Për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re" ai ka thënë se ky termocentral do të ndërtohet dhe do të jetë një projekt model si për nga cilësia, po ashtu për nga ndikimi dhe rritja ekonomike

## AKTUALE




**HOXHAJ: SERBIA NUK DUHET TË KETË FRIKË NGA ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË INTERPOL** F. 5

**HARADINAJ: MIRATIMI I AGJENDËS ERA, JETIK PËR KOSOVËN** F. 7

**KOMUNA E MALISHEVËS TRI FAMILJE I BËNË ME SHTËPI PËR BANIM** F. 10

## Kuvendi po bëhet jofunksional, dështon seanca e thirrur për politikën e jashtme

FAQE 3



# Kurti: Thaçi nuk guxon të nënshkruajë marrëveshje me Vuçiqin pa mandat të Kuvendit

FAQE 3

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka thënë të premten se presidenti i vendit, Hashim Thaçi, përderisa nuk ka mandat legjitimues nga Kuvendi dhe as ekip negociator nga Qeveria, nuk do të guxojë të nënshkruajë marrëveshje me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Në një konferencë për medie, Kurti u ka bërë thirrje AAK-së e Nismës që të mos formojnë ekip negociator i cili do t'i shërbente Thaçit për të dëshmuar para faktorëve ndërkombëtarë se ai nuk është i vetmuar




## EKONOMI

**MINISTRIA E FINANCAVE: EKONOMIA VENDORE PRITET TË RRITET RRETH 4.3 PËR QIND** F. 8

**FINANCIMI I NDËRMARRËSISË TA NXISË HAPJEN E BIZNESEVE TË REJA** F. 9

## SPORT

**GASHI: SPORTI I PARAGLAJDIZMIT TË PROMOVOHET SA MË SHUMË NË KOSOVË** F. 18



RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosove,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Scotti: Beogradi dhe Prishtina të tregojnë fleksibilitet

BEOGRAD, 16 NËNTOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, është takuar të premten me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara në Beograd, Kyle Scott, me të cilin ka biseduar për marrëdhëniet dypalëshe, bashkëpunimin ekonomik dhe dialogun në mes të Beogradit dhe Prishtinës.
Siç është thënë në komunikatën që e ka transmetuar Shërbimi i Ballkanit i "Radios Evropa e Lirë", Vuçiqi e ka informuar ambasadorin Scott se Prishtina me vënien e taksës mbi prodhimet e Serbisë dhe Bosnjës, ka shkelur Marrëveshjen e tregtisë së lirë në Evropën Qendrore-CEFTA.
"Vuçiqi ka shprehur kënaqësinë e tij për rritjen e shkëmbimit tregtar mes Serbisë dhe ShBA-së, si dhe për rritjen e interesit të kompanive amerikane për investime në Serbi", është thënë në komunikatë.
Scott në anën tjetër u ka bërë thirrje Beogradit dhe Prishtinës që të tregojnë fleksibilitet në arritjen e një zgjidhjeje që do t'i kontribuonte stabilitetit në rajon.



# Kuvendi po bëhet jofunksional, dështon seanca e thirrur për politikën e jashtme

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, e thirrur për të premten nga opozita, në të cilën ishte paraparë të diskutohej për politikën e jashtme, ka dështuar për shkak të mungesës së kuorumit dhe mospranisë së ministrit të Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Kuvendi i Kosovës nuk po arrin ta përmbyllë me ndonjë rezultat apo vendim asnjë nga seancat e jashtëzakonshme të cilat po thirren qoftë nga Qeveria, qoftë nga opozita. Mungesa e një shumice parlamentare në Kuvend po ndikon në vendimmarrje dhe në funksionimin e këtij institucioni. Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, e thirrur për të premten nga opozita, në të cilën ishte paraparë të diskutohej për politikën e jashtme, ka dështuar për shkak të mungesës së kuorumit dhe mospranisë së ministrit të Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli.
Deputetët pjesëmarrës në seancë thanë se mbajtja e seancës pa praninë e kryeministrit Ramush Haradinaj dhe ministrit të Jashtëm të Kosovës, Behgjet Pacolli, nuk ka kuptim.
Propozuesi i seancës, shefi i Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, tha se në mungesë të plotë të deputetëve të koalicionit qeverisës dhe kabinetit qeveritar, Kryesia e Kuvendit duhet të caktojë në mbledhjen e radhës se kur do të mbahet seanca e jashtëzakonshme. "Është obligim kushtetues i koalicionit qeverisës, jo i shumicës parlamentare tani, sepse nuk janë shumicë parlamentare, që të



jenë të pranishëm në seancë. Ne e kuptojmë plotësisht ndjeshmërinë e temës dhe qëllimi i kësaj seance ka qenë që ta qartësojmë edhe më mirë politikën e jashtme karshi arritjes së objektivave që ka Republika e Kosovës. Por, në mungesë të plotë të deputetëve të koalicionit qeverisës dhe të Qeverisë, kabinetit qeverisës, ne propozojmë që data kur mbahet kjo seancë të caktohet në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë së Kuvendit", ka thënë Hoti.
Ndërkaq shefi i Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka bërë me dije se me kohë është marrë një shkresë nga kryeministri dhe zëvendëskryeministri që nuk do të mund të jenë të pranishëm në seancë për të diskutuar për çështjet e ngritura. "Meqenëse situata është si është, nuk i kemi të pranishëm, besoj se është e rrugës që, ashtu siç kemi biseduar edhe më parë, ta caktojmë (seancën) në një datë tjetër. Dhe është, po ashtu, e rëndësishme që kjo seancë, meqenëse trajton temën e politikës së jashtme, të caktohet pas votimit për anëtarësimin e Kosovës në Interpol, që duhet të ndodhë më datën 20", ka thënë Krasniqi.
Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se LDK-ja dhe LV-ja e dinin se nuk do të mbahej kjo seancë. Sipas tij, këto dy parti veçse erdhën për ta sharë Qeverinë dhe pastaj ikën. "E dinin që s'mbahej mbledhja. Erdhën, e shanë Qeverinë dhe ikën. Thanë pse nuk ka ardhur kryeministri, e ai as që ishte thirrur në këtë seancë. Kjo ishte detyra e opozitës sot. E jona është t'i kalojmë edhe metrat e fundit për t'u bërë pjesë e Interpolit dhe t'i kapërcejmë edhe pengesat enorme për liberalizimin e vizave!", ka shkruar deputeti Nitaj.

# Arrestohet Hysri Peqani-'Burdushi', në shtëpinë e tij gjenden edhe armë

PRIZREN, 16 NËNTOR - Policia e Prizrenit ka arrestuar Hysri Peqanin, mjekun popullor të njohur me emrin "Burdushi". Lajmin për arrestimin e "Burdushit" e ka konfirmuar për "KosovaPress" prokurori i rastit, Petrit Kryeziu. Sipas tij, Peqani është i dyshuar për veprat penale shmangie tatimi dhe mashtrim. "Gjatë bastisjes janë gjetur armë dhe municion dhe, po ashtu, janë sekuestruar dëshmi të tjera materiale që duhen për hetime të mëtutjeshme", ka thënë Kryeziu. Peqani me urdhër të prokurorit është ndaluar për 48 orë. Ditë më parë Prokuroria e Prizrenit ka ngrehur aktakuzë ndaj Peqanit për veprën penale mashtrim.



## Meta takon Ruçin për dekretimin e Sandër Lleshajt

TIRANË, 16 NËNTOR - Presidenti i Shqipwrisw, Ilir Meta është takuar me kryeparlamentarin Gramoz Ruçi, pak pas dekretit të tij për të liruar nga detyra e ushtarakut, gjeneral Sandër Lleshaj.
Me anë të dekretit Meta hap dritën jeshile dekretimit të tij si ministër i Brendshëm pas propozimit për të dytën herë, nga kryeministri Edi Rama.
Takimi mes Metës dhe Ruçit ka zgjatur afro 20 minuta dhe është mbajtur në një hotel në qendër të Tiranës, takim që mësohet se do t'i shërbejë gjetjes së një zgjidhjeje përfundimtare për postin e ministrit të Brendshëm.
Të dy kanë pirë nga një kafe, e



cila ka zgjatur 30 minuta, ndërsa punonjësit e Gardës kanë mbajtur larg medien.
Në 14 pyetjet e kryetarit të shtetit për statusin e Sandër Lleshajt, dukej shqetësimi se i emëruari i Edi Ramës ishte ushtarak i lartë. Njëherazi, vetë Lleshaj bëri kërkesë për zhdekretimin e tij dhe largimin nga karriera ushtarake, kërkesë që u miratua.
Por, çfarë do të ndodhë pas kësaj? Burime thonë se, edhe afati i dytë kushtetues mund të digjet. Ndërkohë, të hënën kryeministri mund ta ripropozojë për herë të tretë emrin e Sandër Lleshajt në postin e ministrit të Brendshëm.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka mbajtur konferencë për medie

# Kurti: Thaçi nuk guxon të nënshkruajë marrëveshje me Vuçiqin pa mandat të Kuvendit

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka thënë të premten se presidenti i vendit, Hashim Thaçi, përderisa nuk ka mandat legjitimues nga Kuvendi dhe as ekip negociator nga Qeveria, nuk do të guxojë të nënshkruajë marrëveshje me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Në një konferencë për medie, Kurti u ka bërë thirrje AAK-së e Nismës që të mos formojnë ekip negociator i cili do t'i shërbente Thaçit për të dëshmuar para faktorëve ndërkombëtarë se ai nuk është i vetmuar. Sipas Kurtit, çfarëdo ekipi negociator tash vetëm u jep hov negociatave




EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka deklaruar të premten se presidenti Hashim Thaçi, përderisa nuk ka mandat legjitimues nga Kuvendi dhe as ekip negociator nga Qeveria, nuk do të guxojë të nënshkruajë marrëveshje me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Këto komente Kurti i ka bërë në një konferencë me gazetarë, ku ka folur edhe për procesin e korrigjimit të kufirit midis Kosovës dhe Malit të Zi. Ai ka rikujtuar se edhe pas nëntë muajve nuk ka korrigjim të kufirit. Megjithatë, Kurti ka thënë se ratifikimi i demarkacionit me Malin e Zi e ka inkurajuar Thaçin për aventurën e tij për pazare territoriale me Serbinë, në emër të një demarkacioni të ri me të, të një korrigjimi tjetër nga i cili ne sërish dalim humbës. "Haradinaj i dha 8 200 hektarë për ulësen e kryeministrit. Thaçi e jep veriun për ulësen e presidentit, ndërkohë që shtiret se kjo është për ulësen e Kosovës në OKB. Territor për karrige, gjithsesi. Territor shteti për karrige pushteti. Mirëpo, kot bredh Thaçi poshtë e lart si paparazi. Derisa ai nuk ka mandat legjitimues nga Kuvendi dhe as ekip negociator nga Qeveria, nuk do të guxojë të nënshkruajë marrëveshje me Vuçiqin", ka deklaruar Kurti.

Ai u ka bërë thirrje AAK-së e Nismës që të mos formojnë ekip negociator i cili do t'i shërbente Thaçit për të dëshmuar para faktorëve ndërkombëtarë se ai nuk është i vetmuar. "Thaçi është dhe duhet të mbetet i vetmuar. Në protestën e 29 shtatorit u dëshmua që populli ynë nuk i nënshtrohet këtij njeriu. Çfarëdo ekipi negociator tash vetëm u jep hov negociatave dhe shërben si dhjam për arushën, si imunitet për presidentin në këtë aventurën e tij me agjendë serboruse", ka theksuar ai, duke shtuar se Thaçi në fund të këtij procesi do të kërkojë azil në Rusi. "Para dy vjetëve e gjysmë, pakkujt, në mos askujt, nuk ia ka marrë mendja që fiton Trumpi apo ngjan BREXIT-i. Mirëpo, para vetëm një viti e gjysmë askujt, ama bash askujt, nuk ia ka marrë mendja që ish-kryeministri maqedonas Gruevski do të kërkojë azil politik në Hungari. Prandaj, asaj rruge është edhe Thaçi - drejt azilit në Rusi. Ne nuk mund ta ndalim në rrugën e tij. Por, ne mund dhe duhet ta ndalim që ai ta marrë Kosovën me vete. Kosova nuk futet dot në valixhe. Asnjëherë, të askujt. Toka jonë është e shkriftë, sepse historikisht është përplot gjak, lot e djersë të brezave. Të palarat e veta në valixhen e tij, Thaçi nuk i shkëmben dot me tokë të Kosovës", është shprehur Kurti.

Në këtë konferencë Kurti ka prezantuar alternativën e Lëvizjes Vetëvendosje për bisedime me Serbinë e cila përbëhet nga katër hapa. Sipas Kurtit, dy hapat e parë mund të bëhen edhe para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Kurse hapat 3 dhe 4, vetëm pas zgjedhjeve, kur dalin institucionet me legjitimitet të freskët. Kurti ka treguar se hapi i parë është shqyrtim dhe vlerësim i dialogut gjashtëvjeçar (2011-2017) në Kuvendin e Republikës. Kurse në hapin e dytë, sipas tij, duhet të dihet se çfarë dëshiron dhe cilat janë qëllimet e Kosovës në bisedimet me Serbinë. Ndërsa hapi i tretë ai ka thënë se është platforma me parime e Republikës së Kosovës për bisedime me Serbinë. Sipas Kurtit, hapi i katërt duhet të jetë ekipi negociator me legjitimitet nga Kuvendi, me përbërje gjithëpërfshirëse, udhëheqje kredibile dhe strategji përkatëse. "E vetmja gjë që nuk mund të jetë publike në këta katër hapa, është strategjia e ekipit negociator. Gjithçka tjetër duhet të jetë transparente. Ky ekip negociator i raporton Kuvendit të Republikës dhe komisioneve të tij varësisht prej kërkesave dhe nevoja siç është normale në një republikë parlamentare si puna e shtetit të pavarur të Kosovës", ka deklaruar Kurti.

## Gramoz Ruçi u bënë thirrje vendeve që s'e kanë njohur Kosovën, ta njohin



TIRANË, 16 NËNTOR - Në ditën e fundit të sesionit të dytë plenar të Parlamentit Ndërkombëtar për Tolerancën dhe Paqen, i cili po zhvillohet në Tiranë, kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi, ka përsëritur thirrjen para delegacioneve të huaja pjesëmarrëse për njohjen e Kosovës. "Në këtë tribunë në emër të popullit të Shqipërisë dhe të kombit shqiptar ju bëj thirrje që t'i rikujtoni kolegët tuaj parlamentarë, por dhe qeveritë që ju keni votuar, se Republika e Kosovës, një shtet i ri i krijuar prej një dekade prej përpjekjesh titanike të forcave më progresiste të botës, kërkon me legjitimet, me meritë dhe dinjitet, më shumë njohje ndërkombëtare. Qeveritë e vendeve anëtare të Parlamentit Ndërkombëtar për Tolerancën Fetare dhe Paqen që nuk e kanë njohur ende Kosovën i kontribuojnë kështu paqes, tolerancës, stabilitetit dhe sigurisë globale nëse do ta kryejnë aktin e madh moral politik dhe paqësor të njohjes së Republikës së Kosovës", ka thënë Ruçi.

Flet për "Epokën e re", Valdrin Lluka

# Deri në përfundim të mandatit ndërmarrjet publike do të jenë të vetëqëndrueshme

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka bërë me dije se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve publike qendrore kanë rritje të hyrash financiare për vitin 2017. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se që nga marrja e mandatit të tij të ministrit ridefinimi i objektivave dhe marrja e masave korrigjuese në disa ndërmarrje ka prodhuar rezultate fillestare. Lluka ka thënë se disa prej masave të para që janë ndërmarrë janë ndërprerja e shpenzimeve të panevojshme dhe shpërndarja e bonuseve tek anëtarët e bordit dhe punëtorët. "Jam optimist se deri në përfundim të mandatit katërvjeçar ndërmarrjet publike do të jenë të vetëqëndrueshme", ka thënë Lluka. Për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re" ai ka thënë se ky termocentral do të ndërtohet dhe do të jetë një projekt model si për nga cilësia, po ashtu për nga ndikimi dhe rritja ekonomike



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

**Prishtinë, 16 nëntor** - **"Epoka e re":** *Z. Lluka, na thoni si është gjendja në ndërmarrjet publike aktualisht dhe sa jeni optimist se në mandatin tuaj do të ketë përparim?*

**Lluka:** Sipas vlerësimeve të fundit, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve publike qendrore kanë rritje të të hyrave financiare për vitin 2017, veçanërisht operimi financiar i ndërmarrjes KEK është tejet pozitiv, pasi e njëjta ka shënuar fitim për vitin 2017 afërsisht 20 milionë euro. Vlerësoj se që nga marrja e mandatit ridefinimi i objektivave dhe marrja e masave korrigjuese në disa ndërmarrje ka prodhuar rezultate fillestare. Disa prej masave të para që janë ndërmarrë janë ndërprerja e shpenzimeve të panevojshme dhe shpërndarja e bonuseve tek anëtarët e bordit dhe punëtorët. Po ashtu, vlerësoj se draftligji i ri i cili është përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik është hap pozitiv me qëllim të krijimit të strukturave të pavarura dhe profesionale, riorientimit të politikave të ndërmarrjeve publike, me theks riorganizimi i ndërmarrjeve publike me qëllim të përmirësimit të problemeve që deri më tani kanë përcjelle ndërmarrjet publike në përgjithësi. Jam optimist se deri në përfundim të mandatit katërvjeçar ndërmarrjet publike do të jenë të vetëqëndrueshme, çfarë do të thotë se të njëjtat nuk do të subvencionohen më nga Qeveria.

**"Epoka e re":** *Çështje problematike apo neglizhim dhe interferim politik shihet te Posta. Çfarë planesh të afërta keni?*

**Lluka:** Posta e Kosovës është ndërmarrje tejet specifike dhe me rëndësi publike. Së fundmi e njëjta është përballur me disa vështirësi. Megjithatë, me propozimin tim, Qeveria e Kosovës ka ndarë për të njëjtën një shumë simbolike të hollash me qëllim të mbulimit të disa prej shpenzimeve operative. Sfidues mbetet përcaktimi i saktë për shërbimin universal postar të cilin do ta adresojmë në pjesën e parë të vitit 2019 në bashkëpunim me bordin e ri të kësaj ndërmarrje.

**"Epoka e re":** *Deri ku ka shkuar puna sa i përket draftstatutit të "Trepçë"-s?*

**Lluka:** Sa i përket ndërmarrjes "Trepça Sh.A", deri më tani kemi marrë të gjitha hapat e nevojshëm me qëllim të funksionalizimit të ndërmarrjes. Qeveria e Kosovës ka emëruar bordin mbikëqyrës si hap fillestar, i cili ka propozuar për Kuvendin e Kosovës draftstatutin, gjithsesi, me qëllim të akomodimit të kërkesave të Sindikatës së Punëtorëve. Si ministër përgjegjës kam themeluar dy grupe punuese të cilat kanë dërguar rekomandimet e tyre në Kuvendin e Kosovës me qëllim të kompletimit të statutit. Jam i bindur se deri në përfundim të këtij viti Kuvendi i Kosovës, si organ përgjegjës për miratimin e statutit, do ta përfundojë obligimin e tij dhe do të bëhet regjistrimi i Trepçës si shoqëri aksionare. Jam tejet optimist se me regjistrimin e ndërmarrjes do të hapet një fazë e re dhe investimet nuk do të mungojnë. Trepça do të kthehet si promotor i zhvillimit ekonomik dhe për këtë mbetem i përkushtuar.

**"Epoka e re":** *Z. Lluka, është paralajmëruar edhe tërheqja e BERZh-it nga termocentrali "Kosova e Re". Sa do ta prolongojë finalizimin e këtij projekti?*

**Lluka:** BERZh-i nuk ka qenë asnjëherë i kyçur në projektin e ndërtimit të Termocentralit "Kosova e Re". Qeveria e Kosovës nuk ka pasur konsideratë për mbështetjen e BERZh-it në këtë projekt. "Kosova e Re" do të ndërtohet dhe do të jetë një projekt model si për nga cilësia, po ashtu edhe për nga ndikimi dhe rritja ekonomike që do ta ketë Republika e Kosovës. Jam i sigurt se ky projekt do të hapë perspektivë të qartë për të ardhmen ekonomike të vendit.

**"Epoka e re":** *Mospranimi i Kosovës në ENTSO, sa do ta dëmtojë Kosovën?*
**Lluka:** Pranimi në ENTSO do të ndodhë në një të ardhme të afërt. Është fatkeqësi që një trup tejet teknik si ENTOS të jetë i varur tërësisht nga vendime politike. Kosova padrejtësisht është trajtuar nga ky trup për shumë vjet. Qytetarët tanë, për shkak të këtij trajtimi, janë dëmtuar për vite me radhë. Sa i përket mospranimit, ditë më parë propozimi për një formë të tillë të pranimit nuk ka qenë i



përshtatshëm për Republikën e Kosovës, pra ne si Qeveri e kemi kundërshtuar propozimin e ENTSO-s, rrjedhimisht ky vendim nuk na ka dëmtuar. Ne aspirojmë të jemi anëtarë të ENTSO-s me të drejta të plota sikurse të gjitha shtetet e pavarura të Evropës, prandaj edhe abstenimi i shteteve mike ka qenë në përputhje me qëndrimin tonë.

**"Epoka e re":** *Dy shtetet fqinje abstenuan në votimin për anëtarësimin e Kosovës (KOSTT) në ENTSO. Pse ndodhi kjo dhe a është lobuar në këtë drejtim?*
**Lluka:** Në kohën e duhur do t'i marrim të gjitha masat që shtetet mike të jenë të radhitura përkrahë nesh për anëtarësim të Kosovës si shtet me të drejta të plota.

**"Epoka e re":** *Po ashtu, prolongim kemi edhe tek Interkonjuksioni. A duhet të ridialogohen sërish në Bruksel marrëveshjet me Serbinë?*
**Lluka:** Moszbatimi i marrëveshjes së Interkoneksionit, e arritur si pjesë e bisedimeve të lehtësuara nga BE-ja në mes të Prishtinës dhe Beogradit, është çështje tejet shqetësuese. Këto shqetësime i kam paraqitur në të gjitha forumet, konferencat dhe takimet me ministra homologë të vendeve të regjionit dhe BE-së, me përfaqësues të ambasadave të akredituara në Kosovë si dhe me komisionarin Hahn. Qeveria e Kosovës i ka përfunduar të gjitha obligimet e v eta të marra me marrëveshje, por që e njëjta nuk është bërë nga ana e Beogradit. Vlerësoj se moszbatimi i kësaj marrëveshje, përveçse shënon dëme të pariparueshme për Republikën e Kosovës, është akt i padrejtë dhe në kundërshtim me çdo praktikë ndërkombëtare apo të fqinjësisë. Padrejtësisht që 20 vjet ne kemi paguar energjinë elektrike për qytetarët e veriut. Megjithëse mbesim të përkushtuar që t'i furnizojmë qytetarët tanë të veriut me energji, mospagimi i kësaj energjie të shpenzuar është akt i papranueshëm. Kohë më parë kam kërkuar vendosjen e taksës prej 5 përqindësh për produkte që hyjnë nga Serbia në emër të kompensimit të kësaj energjie dhe më vjen mirë që së fundmi Qeveria e ka marrë një vendim të tillë.
Gjithsesi, mbesim të përkushtuar për ta zgjidhur përfundimisht këtë çështje dhe për këtë janë të njoftuar të gjithë, duke përfshirë edhe krerët më të lartë të BE-së. Jam optimist se shumë shpejt do të gjendet një zgjidhje. Për këtë jam duke punuar dhe do të njoftoheni së shpejti.

**"Epoka e re":** *Është paralajmëruar dënim nga ARKEP-i nëse pas 15 janarit operatorët Vala dhe IPKO do të gjobiten për mosimplementim të kodit +383. A rrezikohet që për gjobën e VALA-s të paguhet nga buxheti i shtetit, marrë parasysh gjendjen financiare në këtë ndërmarrje?*
**Lluka:** Implementimi i tërësishëm i kodit +383 është përcaktim institucional dhe do të ndodhë brenda afateve të parapara nga ARKEP-i. "Telekomi i Kosovës" Sh.A. do të gjejë forma që ta bëjë implementimin e plotë në kodin e ri shtetëror të Republikës së Kosovës.

# Hoxhaj: Serbia nuk duhet të ketë frikë nga anëtarësimi i Kosovës në Interpol

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka thënë se Serbia nuk duhet të ketë frikë nga anëtarësimi i Kosovës në Interpol, por nga e kaluara e saj e pazgjidhur kriminale. Hoxhaj përmes një postim në llogarinë e vet në "Twitter" ka shkruar se Serbia ka një të kaluar të njohur të keqpërdorimit të njoftimeve të Interpolit. "Serbia ka një të kaluar të njohur të abuzimit, të keqpërdorimit të njoftimeve të Interoplit, si një formë agresioni ndaj fqinjëve të vet. Kosova ka një histori të dëshmuar të bashkëpunimit me agjencitë e zbatimit të ligjit. Serbia nuk duhet të ketë frikë nga Kosova në Interpol, por nga e kaluara e saj e pazgjidhur kriminale", ka shkruar zëvendëskryeministri Hoxhaj.
Edhe Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) nëpërmjet një deklarate për medie ka rithekësuar qëndrimin e saj zyrtar se procesi i anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Interpol i kontribuon fuqishëm rritjes së efikasitetit të bashkëpunimit fqinjësor, rajonal dhe ndërkombëtar për parandalimin dhe luftimin e krimit transnacional dhe paralelisht me këtë ndihmon forcimin e sigurisë dhe ruajtjen e rendit ndërkombëtar.
Ministria e Punëve të Jashtme është shprehur thellësisht e bindur se ky proces i shërben jo vetëm interesit kombëtar të shtetit të Kosovës dhe shtetasve të saj, por edhe të gjitha shteteve anëtare të kësaj organizate dhe shtetasve të tyre. Në mbështetje të kësaj, Ministria e Punëve të Jashtme konsideron se nga anëtarësimi i Kosovës në Interpol do të fitojnë të gjithë shtetet anëtare dhe shtetasit e tyre, ndërsa humbës do të jetë vetëm krimi trasnacional. "Republika e Kosovës, respektivisht organet e saj të rendit dhe ligjit, në dhjetëvjeçarin e tyre të ekzistencës si shtet ka demonstruar profesionalizëm të lartë dhe ka marrë vlerësime të mëdha për kryerjen e suksesshme të operacioneve të përbashkëta transnacionale si me Interpolin dhe me organizata të tjera, ashtu edhe si një anëtare serioze, kredibile dhe e përkushtuar ndërkombëtare në koalicionin global në luftën kundër terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit", është thënë në deklaratën e MPJ-së.
Ministria e Punëve të Jashtme i ka prezantuar me kohë argumentet e veta bindëse ligjore dhe profesionale të gjitha shteteve anëtare në mbështetje të anëtarësimit të vendit në Interpol dhe u bënë thirrje edhe një herë të gjitha shteteve anëtare që të votojnë në favor të rritjes së efikasitetit të bashkëpunimit fqinjësor, rajonal dhe ndërkombëtar për parandalimin dhe luftimin e krimit transnacional, respektivisht anëtarësimit të Kosovës.



# Haradinaj: Kosova ka krijuar mjedis të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave të secilit



**Zbatimi i legjislacionit dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit ishin në fokus të takimit të grupit koordinues ndërministror për të drejtat e njeriut në të cilin ka marrë pjesë edhe kryeministri Ramush Haradinaj. Ai ka theksuar se dy dekada më parë si popull e kemi ndjerë në thelb cenimin e të drejtave të njeriut, por sot Kosova duhet të bëhet lidere për mbrojtjen e tyre**

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Të premten është mbajtur takimi i grupit koordinues ndërministror për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës. Në këtë takim ka marrë pjesë edhe kryeministri Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se në Kosovë janë aprovuar disa ligje që kanë peshë dhe që vërtet e japin një garanci të zbatimit të të drejtave të njeriut. Haradinaj, duke shtuar se si fushë e gjerë që është, të drejtat e njeriut përfshihen në Kushtetutë të secilit vend në botë dhe secili ligj i aprovuar nuk bën të bjerë ndesh me të drejtat e njeriut.

Kryeministri Haradinaj ka shtuar se janë edhe disa ligje të posaçme për të drejtat e njeriut që bëhen në mënyrë që të jepet qartësia e fundit. "Ndihem mirë që edhe Kosova e ka Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, pastaj Ligjin për Avokatin e Popullit dhe Ligjin për Barazi Gjinore", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se këto ligje ia kanë mundësuar Kosovës ta ketë bazën e nevojshme ligjore për respektimin e të drejtave të njeriut.

Duke vlerësuar se duhen shtuar veprimet ndërinstitucionale, kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosova duhet të kthehet në një shembull të respektimit të të gjitha atyre të drejtave që konventat ndërkombëtare i njohin dhe respektojnë. "Kosova ka krijuar infrastrukturë solide ligjore në këtë fushë. Kur kësaj i shtohet respekti për tjetrin dhe vlerat e tij, si dhe humanizmi i popullit tonë për të cilin shquhemi në botë, ne mund të krenohemi se vërtet kemi krijuar një mjedis të përshtatshëm, ku mbrohen të drejtat e secilit", ka theksuar kryeministri Haradinaj. Ai ka theksuar se dy dekada më parë si popull e kemi ndjerë në thelb cenimin e të drejtave të njeriut, por sot Kosova duhet të bëhet lidere për mbrojtjen e tyre.

Në përfundim të takimit, kryeministri Haradinaj ka kërkuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë që të përgatisë një raport nga ekzekutivi, nga të gjeturat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, duke respektuar gjithë bazën e të arriturave deri më sot, që pastaj të krijohet një trup punues ndërministror, me shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, për zbatimin e strategjisë së të drejtave të njeriut në vend.

Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, ka thënë se vlerat si demokracia, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit përbëjnë gurthemelin e të gjitha institucioneve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por edhe të gjitha organizatave në të cilat ky vend në të ardhmen e afërt synon t'u bashkëngjitet.

# 'Drejtësia 2020' përafron Kosovën me standardet evropiane në luftën kundër korrupsionit

PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka marrë pjesë në të premten në konferencën rreth përputhshmërisë së Kosovës me standardet evropiane dhe ndërkombëtare të Luftës Kundër Korrupsionit (LKK) dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (PPP/LFT), organizuar nga projekti i përbashkët i BE/Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik (PECK II).

Ministri Tahiri ka theksuar se lufta kundër korrupsionit, pastrimit së parasë dhe financimit të terrorizmit nënkupton punë të vazhdueshme për ndërmarrjen e një varg masash dhe koordinim institucional mes shumë aktorëve të përfshirë në sundimin e së drejtës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. "Të gjitha analizat, përfshirë të gjeturat e Raportit të Progresit dhe ato të Këshillit të Evropës, vlerësojnë se Kosova ka ndërmarrë hapa të vlefshëm për vendosjen e kornizës ligjore dhe mekanizmave institucionalë në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit" ka theksuar ministri.

Për ta fuqizuar luftimin e korrupsionit, ministri Tahiri ka përmendur ndryshimet e bëra legjislative, Kodin Penal, ligjin për kompetencat e zgjeruara në konfiskimin e pasurisë së fituar me aktivitet kriminal si dhe ai për mbrojtjen e sinjalizuesve, gjithashtu edhe iniciativat e ndërmarra të rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit si dhe agjendën e përbashkët "Drejtësia 2020". "Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe lufta kundër korrupsionit kërkon përkushtim në analizë, rishikim dhe plotësim të zbrazëtirave ligjore, efikasitet të shtuar të mekanizmave institucionalë dhe ndërveprim të ngushtë në mënyrë që të arrihen rezultate konkrete. Derisa rishikimi funksional është proces strategjik që merr kohë, ne kemi vendosur prioritetet në kuadër të agjendës 'Drejtësia 2020' edhe ndërmarrjen e masave praktike për sigurimin e përputhshmërisë së Kosovës me standardet evropiane në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar" ka theksuar ministri Tahiri.



Mbahet takimi i radhës i nivelit të lartë për sundim të ligjit

# Haradinaj: Miratimi i agjendës ERA, jetik për Kosovën

**Kosova duhet t'i shtojë përpjekjet për ta unifikuar agjendën për integrim evropian. Kështu ka thënë të premten kryeministri Ramush Haradinaj në takimin e radhës të nivelit të lartë për sundim të ligjit. Ai ka vlerësuar se pakoja e ligjeve, që buron nga Agjenda e Reformave Evropiane dhe shtyrja përpara e saj për miratim në Kuvend, është jetike Kosova të lëvizë shpejt përpara për përmbushjen e kësaj agjende shtetërore**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se institucionet e Kosovës duhet t'i shtojnë përpjekjet për ta unifikuar agjendën për integrim. Në takimin e radhës të nivelit të lartë për sundim të rendit dhe ligjit, në të cilin është prezantuar progresi i Kosovës në këtë fushë si dhe të arriturat sa i përket pakos së ligjeve për Agjendën e Reformave Evropiane (ERA), kryeministri ka thënë se miratimi i agjendës ERA është jetik për të ardhmen e Kosovës. Ai ka thënë se institucionet e Kosovës duhet të angazhohen edhe më shumë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, t'i aprovojnë ligjet që ndërlidhen me procesin e integrimit evropian, pasi Kosova është në fazën finale të procesit të liberalizimit të vizave. "Kosova duhet t'i shtojë veprimet që ndërlidhen me përafrimin me BE-në. Pakoja e ligjeve, që buron nga Agjendën e Reformave Evropiane, dhe shtyrja përpara e saj për miratim në Kuvend, ishte fokus i takimit të sotëm të nivelit të lartë për sundimin e ligjit. Meqenëse kjo pako legjislative, që fuqizon shtetin ligjor, ka ndikim në liberalizimin e vizave dhe avancon Kosovën në rrugëtimin drejt BE-së, është jetike që të lëvizim shpejt përpara për përmbushjen e kësaj agjende shtetërore", ka thënë Haradinaj pas takimit.

Në këtë takim është biseduar edhe për rastet e shënjestruara dhe për pakon e ligjeve që ndërlidhen me liberalizimin e vizave, kodin penal, konfiskimin e pasurisë, mbrojtjen e informatorëve, duke mos lënë anash edhe të arriturat sa i përket Agjendës së Reformave Evropiane, për të cilat është thënë se janë shënuar rezultate, por kërkohet që edhe më tutje të ketë dinamikë të shtuar.

Përfaqësuesit e tjerë institucionalë kanë shprehur gatishmërinë dhe zotimet e tyre për përmbushjen e të gjitha obligimeve në këtë proces sipas dinamikës së paraparë.

Të arriturat institucionale në këtë takim i ka paraqitur edhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i cili ka vlerësuar se votimi i pakos së ligjeve në Kuvendin e Kosovës është jetik për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Tahiri ka bërë me dije se, përveç përmbushjes së obligimeve të dala nga Agjenda e Reformave Evropiane, hartimin e një sërë pakosh së ligjeve, ndër të cilat pakoja e ligjeve kundër korrupsionit, rishikimi i drejtësisë penale, pakoja e ligjeve të gjyqësorit, po ashtu janë ndërmarrë edhe iniciativa të tjera për ta përmirësuar menaxhimin dhe performancën e sektorit të drejtësisë. "Duke pasur parasysh nevojën për ta dëshmuar vendosmërinë tonë si Republikë, si partner serioz në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ka qenë shumë e rëndësishme edhe rishikimi i drejtësisë penale. Këto ndryshime do të na nxjerrin në një dimension tërësisht të ri dhe më të fuqishëm sa i përket luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit", ka theksuar ministri Tahiri.

Miratimi i akteve ligjore të sektorit të drejtësisë në leximin e dytë në Kuvendin e Kosovës, sipas ministrit Tahiri, do të kenë ndikim edhe në rangimin tonë si shtet, edhe në procesin e liberalizimit të vizave, edhe në vlerësimin nga ana e Komisionit Evropian në raportet e vendit. "Janë 16 projektligje të Ministrisë së Drejtësisë që janë në procedura të Kuvendit në fazë të ndryshme. Konsideroj se miratimi final sa më shpejt i projektligjeve siç janë Kodi Penal, Projektligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ai për Konfiskimin e Pasurisë dhe ai për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, nga ana jonë si shtet, e përmbyllin kapitullin dhe e fuqizojnë kauzën tonë të drejtë për liberalizimin e vizave" është shprehur Tahiri.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin edhe e ngarkuara me punë në Misionin e Shteteve të Bashkuara në Republikën e Kosovës, Colleen Hyland, përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Riccardo Serri, shefja e EULEX-it, Alexandra Papadopoulos dhe shefja e USAID-it, Lisa Magno.



## Procesi i verifikimit dhe njohjes së statusit të viktimave të dhunës seksuale të luftës po vazhdon

PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka marrë pjesë të premten në takimin me grupin koordinues ndërministror për të drejtat e njeriut, në të cilin ka raportuar rreth procesit të verifikimit dhe njohjes së statusit të viktimave të dhunës seksuale të luftës së fundit në Kosovë. "Komisioni qeveritar për verifikim dhe njohjen e statusit të kësaj kategorie ka nisur procesin nga data 5 shkurt 2018, proces i cili është duke vazhduar. Fillimi i njohjes së statusit të viktimave të dhunës seksuale ka qenë një proces i gjatë dhe që ka kërkuar një vendosmëri për t'i marrë vendimet e duhura, që të paktën në këtë formë të jemi më afër këtyre qytetarëve, të cilët më së shumti kanë pasur nevojë për ndihmën tonë", ka thënë ai.

Ministri Reçica ka pohuar se do të angazhohen si MPMS edhe më tutje për këtë kategori duke luftuar stigmën, paragjykimet, duke i ofruar qasje të lehtë në shërbime shëndetësore të mirëfillta, përparësi në punësim dhe aftësim profesional, arsimim kualitativ, rehabilitim, fuqizim ekonomik dhe drejtësi.



# Ministria e Financave: Ekonomia vendore pritet të rritet rreth 4.3 për qind







PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Ministria e Financave, me qëllim të ngritjes së transparencës fiskale dhe informimit të publikut, ka bërë publikimin e radhës së pasqyrës makroekonomike për periudhën korrik-shtator 2018. Nga analiza e publikuar shihet se ekonomia vendore pritet të rritet rreth 4.3 për qind përgjatë vitit 2018, në terma realë, kjo rritje do të vazhdojë të jetë e nxitur kryesisht nga investimet, eksporti dhe konsumi privat. "Duhet veçuar trendi rritës i komponentit të konsumit dhe eksportit të shërbimeve që pritet të kenë rol të theksuar në rritjen e BPV-së. Kontribut të veçantë në këtë rritje të aktivitetit ekonomik vlerësohet të ketë ardhur nga reformat fiskale si dhe reformat strukturore të ndërmarra përgjatë periudhës paraprake. Në kuadër të transparencës fiskale, Ministria e Financave në baza mujore bën edhe përditësimin e shënimeve të serive kohore, ku ofrohen informata me frekuencë të lartë, për nivelin lokal dhe qendror, mbi pranimet (hyrjeve) dhe pagesat (shpenzimeve) fiskale të Qeverisë së Republikës së Kosovës", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Financave.

Ministria e Financave ka njoftuar se do t'i vazhdojë këto publikime si një bazë e mirë për analistët profesionalë, për studentë, për mediat dhe qytetarët në përgjithësi, si mundësi e mirë e monitorimit të performancës fiskale të Qeverisë në baza mujore, për një periudhë mbi dhjetëvjeçare.

# Në Itali diskutohet për bashkëpunimin në fushën e sigurimeve



PRISHTINË, 16 NËNTOR (ER) - Shoqata e Sigurimeve e Kosovës, e përfaqësuar nga Sami Mazreku, drejtor ekzekutiv dhe Venhar Hana, shef i zyrës ligjore, kanë takuar në Itali përfaqësuesit e Shoqatës Nacionale të Kompanive të Sigurimit, Maria Rita Arena dhe Roberto Signorini. Drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Sami Mazreku, ka thënë se ky takim ka për qëllim themelimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me shoqatat e vendeve të tjera dhe ka një rëndësi të veçantë për industrinë e sigurimeve në Republikën e Kosovës. Në këtë takim janë diskutuar çështje me rëndësi për të dyja industritë e sigurimeve si në aspektin ligjor, po ashtu edhe në atë financiar dhe operativ.

Fokus i veçantë u është dhënë modaliteteve që ka ndjekur kjo shoqatë për uljen e numrit të automjeteve të pasiguruara dhe të paregjistruara dhe për rritjen e vetëdijes sociale për sigurimet. Shoqata Nacionale e Kompanive të Sigurimit ka ofruar çdo mbështetje që i nevojitet Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës për t'i arritur qëllimet e saj për zhvillimin e industrisë së sigurimeve.

Shoqata e Sigurimeve të Kosovës ka njoftuar se në vazhdimësi do të ketë takime me shoqata të vendeve si ajo e Hungarisë, Kroacisë dhe të tjera.

# Financimi i ndërmarrësisë të nxisë hapjen e bizneseve të reja

Anëtari i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, Ramis Ahmetaj, ka thënë se Kosova është me fat që ka një sektor bankar shumë stabil që ka ndihmuar në rritjen e sektorit privat në vend. Megjithatë, ai ka shtuar se në nivel global sektori bankar nuk shihet si burim financimi për ndërmarrje të reja

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Financimi i ndërmarrjeve të reja paraqet një ndër elementet kryesore për ekosistemin e ndërmarrësisë në vend. Kjo u tha në tryezën e organizuar nga Oda Amerikane në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë, ku u diskutua mbi alternativat që ndërmarrësit e rinj në vend i kanë në dispozicion për t'i financuar idetë e tyre të biznesit dhe sfidat me të cilat ata ballafaqohen në këtë aspekt.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se gjatë kësaj jave është synuar të trajtohet ndërmarrësia nga kënde të ndryshme në mënyrë që kësaj teme t'i jepet një rëndësi e shtuar në shoqëri. Në këtë drejtim, ai ka thënë se financimi paraqet një element kyç në ekosistemin e ndërmarrësisë dhe, si i tillë, ka rëndësi të madhe për inkurajimin e ndërmarrjeve të reja në vend.

Ramis Ahmetaj, anëtar i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, ka theksuar se Kosova është me fat që ka një sektor bankar shumë stabil që ka ndihmuar në rritjen e sektorit privat në vend. Megjithatë, ai ka shtuar se në nivel global sektori bankar nuk shihet si burim financimi për ndërmarrje të reja, marrë parasysh se bankat menaxhojnë me depozita të individëve dhe risku i financimit të këtyre ndërmarrjeve është zakonisht më i lartë. Rrjedhimisht, Ahmetaj ka sqaruar se financimi përmes ekuitetit në masë të madhe konsiderohet si opsioni më i mirë për ndërmarrësit e ri.

Robert Wright, drejtor ekzekutiv i "Raiffeisen Bank" në Kosovë, ka deklaruar se në Kosovë ekziston një frymë e mirë e ndërmarrësisë dhe ky faktor mund t'i kontribuojë zhvillimit ekonomik në vend, marrë parasysh edhe papunësinë e lartë që ekziston në vend në mesin e të rinjve. Wright ka thënë se anembanë botës ndërmarrjet e reja ballafaqohen me sfida në financim dhe duhet që edhe vetë ndërmarrësit të jenë të gatshëm të marrin një pjesë të riskut përsipër. Po ashtu, ai ka theksuar se edhe ndërmarrjet që veçse janë konsoliduar në treg duhet të sigurohen që kultura e tyre organizative të nxisë ndërmarrësinë brenda kompanisë në mesin e punëtorëve.

Eriola Bibolli, zëvendëskryeshefe ekzekutive e "ProCredit Bank" në Kosovë, ka thënë se sektori bankar është gjithnjë i gatshëm t'i financojë dhe t'i ndihmojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, zhvillimin e inovacionit, por edhe sektorin e teknologjisë informative i cili tashmë është duke u zgjeruar globalisht. Ajo ka shtuar se fokusi i bankës në të ardhmen është që portofolin e kredive ndaj NVM-ve ta orientojë sa më shumë drejt aktiviteteve të prodhimit dhe ndërmarrjeve në sektorin e shërbimeve. Bibolli ka sqaruar se në nivel të Bashkimit Evropian ekzistojnë disa mekanizma që lehtësojnë qasjen në financa për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe se në Kosovë është bërë diçka e ngjashme përmes Fondit për Garantimin e Kredive. Të pranishmit në këtë tryezë patën rastin të diskutojnë mbi mënyrat për të krijuar mekanizma të financimit të ndërmarrjeve të reja në vend, si një hap kyç për zhvillimin e ekosistemit të ndërmarrësisë në vend.




# Filluan punimet për ndërtimin e qarkores së Gjakovës

GJAKOVË, 16 NËNTOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, bashkë me kryeministrin Ramush Haradinaj, të premten kanë inauguruar fillimin e punimeve për realizimin e qarkores së qytetit të Gjakovës. Ky projekt është financim i Ministrisë së Infrastrukturës dhe faza e parë e projektit ka kosto rreth dy 2.2 milionë euro, ndërsa do të realizohet në afat kohor prej 180 ditë punësh. I tërë projekti kap vlerën mbi tetë milionë euro.

Ministri Pal Lekaj lidhur me rëndësinë e këtij projekti ka thënë se këto investime vijnë falë angazhimit dhe përkushtimit të kryeministrit Ramush Haradinaj. Ministri Lekaj, duke iu adresuar të pranishmëve, ka paralajmëruar që javët në vijim do të fillojë edhe autoudha Gjakovë - Klinë në vlerë prej 57 milionë eurosh, e që nuk do të jetë projekti i fundit për këtë qytet, ngaqë edhe shumë projekte të tjera do të realizohen në vitet në vijim.

I pari i Qeverisë së Kosovës, Ramush Haradinaj, me këtë rast para të pranishmëve deklaroi se ky investim i ka gëzuar të gjithë, por është investim i vogël krahasuar me investimin prej 57 milionë eurosh që do të fillojë së shpejti të implementohet në infrastrukturën e Gjakovës. Kryeministri Haradinaj ka thënë se Gjakova dhe Dukagjini do të përjetojnë edhe shumë projekte të tjera.

Kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, duke falënderuar Qeverinë e Kosovës dhe MI-në për investimin e bërë në Gjakovë, potencoi faktin se që nga mesi i viteve '80 nuk është bërë investim më i madh sesa ky projekt që po fillon së implementuari sot.



# Lirohet nga akuza anëtari i bordit të 'Eco Higjiena'

GJILAN, 16 NËNTOR (ER) - Gjykata Themelore në Gjilan ka shpallur aktgjykim lirues ndaj të akuzuarit S. R. I pandehuri në fjalë është akuzuar nga Prokuroria Themelore e Gjilanit se në fund të vitit 2012 dhe në fillim të vitit 2013, në cilësinë e anëtarit të bordit të kompanisë "Eco Higjiena", me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo person-in tjetër, duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, fillimisht me vendimin e falsifikuar ka formuar komisionin për shitjen e automjeteve të kompanisë, me çka ka dëmtuar kompaninë në vlerë prej 64.327,53 eurosh. Pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve, trupi gjykues ka nxjerrë aktgjykim lirues për të akuzuarin, pasi nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar, nga neni 422, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Palët kanë të drejtën e ankesës ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit.





# Komuna e Malishevës i bën tri familje me shtëpi për banim

MALISHEVË, 16 NËNTOR (ER) - Në kuadër të realizimit të projekteve të Komunës së Malishevës dhe në kuadër të investimeve për rritjen e mirëqenies për familjet në nevojë, kryetari Ragim Begaj ua ka dorëzuar çelësat e shtëpive tri familjeve. Me këtë rast, kryetari Begaj i ka uruar tri familjet për shtëpitë e reja. "Çdo shtëpi e re dhe sigurimi i banimit për secilin banor të komunës sonë na gëzon edhe neve, pavarësisht nëse e ndërton komuna apo ndërtohen përmes donacioneve, pasi me rëndësi është sigurimi i banimit për të gjitha ato familje që kanë nevojë", ka thënë Begaj, duke shtuar se këto tri shtëpi janë në mesin e 13 shtëpive të tjera që kanë ndërtuar këtë vit. "Krahas këtyre investimeve, jemi duke ndërtuar edhe qendrën e banimit social, ku mbi dyzetë familje të tjera do të jenë përfituese dhe besoj se përfundimisht do të zgjidhet problemi i banimit për shumicën e rasteve që kanë nevojë për banim", ka deklaruar Begaj me rastin e përurimit të tri shtëpive në tri fshatra të Komunës së Malishevës.

Me shtëpi të re janë bërë familjet e Hamëz Halilajt nga Llapçeva, Jakup Berishës nga Berisha dhe Muhamet Morina nga Drenoci, ndërsa ndërtimi i shtëpive për këto familje është mundësuar nga buxheti i Komunës së Malishevës.

Në vitet e fundit Komuna e Malishevës në vazhdimësi ka ndërtuar shtëpi banimi për familjet të cilat kanë nevojë për sigurimin e banimit.



# Biznesmenët shqiptarë në Danimarkë, të interesuar të investojnë në Skenderaj

SKENDERAJ, 16 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur në një takim Naim Kadishanin, përfaqësues i kompanisë "Tembobyg" nga qyteti Give i Danimarkës, i cili është një investitor i suksesshëm në fushën e ndërtimtarisë. Kadishani, që shoqërohej nga bashkëpunëtorët, është interesuar për klimën e investimit në Komunën e Skenderajt, ndërkaq kryetari Jashari e ka njoftuar atë duke theksuar sigurinë që ofron komuna sa iu përket investimeve nga jashtë. "Shprehu interesim të investojë në komunën tonë, me hapjen e një fabrike, që do të mundësojë zhvillim ekonomik dhe punësim të të papunëve. U pajtuam që të vazhdojmë të mbesim në kontakt për hapat që do të ndërmerren në vazhdim sa i përket realizimit të projekteve në Skenderaj", ka thënë kryetari Jashari. Ai ka shtuar se në këtë takim kanë diskutuar edhe për mundësinë e binjakëzimit të Skenderajt me Komunën Sønderborg dhe bashkëpunimit në shumë fusha të interesit të përbashkët.

# Asfaltohen pesë rrugë në Lagjen e Re në Ferizaj

FERIZAJ, 16 NËNTOR (ER) - Kushtet e mira klimatike po mundësojnë ende zhvillimin e projekteve infrastrukturore në të gjithë territorin e Komunës së Ferizajt. Tashmë janë asfaltuar pesë rrugë në zonën e qytetit, përkatësisht në Lagjen e Re. Për ta parë asfaltimin e këtyre pesë rrugëve doli i pari i Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me drejtorin e Infrastrukturës, Arbër Bytyqi. Aliu ka thënë se kryerja, sipas dinamikës së punimeve në këto rrugë dhe projekte të tjera infrastrukturore, është dëshmia më e mirë se kjo qeverisje është e përgjegjshme para qytetarëve dhe se ka qasjen e përfundimit me kohë të projekteve të nisura. Rrugët e asfaltuar janë: "Gustav Majer", "Tivari", "Ali Asllani", "Alishefik Spahiu" dhe "Arsim Zeqiri".



(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /24/

# VAZHDIMI I SEANCËS 25/9/1945, FJALA E MBROJTËSVE



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

*(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)*

Sot trupi gjykues tue qenë i formuer si ne seancën e më parme, tue qenë gati PP, Ali Shukrija e prane Mustafa Biçoku si note shkrues u mblodhë ne sallën e gjykimeve (shtepin kulturore).

U sollen te pandehurit nga burgu dhe tue pas pranë tyne mbrojtësit e tyne shoket Xhevdet Pallaska, Zeqi Arni, e Jahja Osmani, u vun ne vendet e posaçme dhe keshtu filloi gjyqi botenisht dhe me dyer të hapura.

Mbi kete Kryetari i gjyqit pyeti PP nese kishte me gjë për të thënë, i cili u përgjigj se nuk kishte, u pyeten gjithashtu mbrojtësit e të pandehurve si dhe të pandehurit nji nga nji nese kishin me gjë per te thenë, per zgjenim te hetimeve, te cilet deklaruan se nuk kishin, te cilet deklaruan se nuk kishin.

Vendim: Me qenë se hetimet e deri tashme shifen te mjaftueshme, trupi gjykues shpalli mbarimin tyre.

Si u deklarue ky vendim PP mori fjalen e thase: Paraqiti pretencën përfundimtare te shkruese, e cila banë pjesë ne kete proces dhe u bashkue me aktet relative.

Zeqi Ali përfaqësues mbrojtes i të pandehrvet Tahir deda, Fehim Ibrahimi, Abdullah Rexhepi, Hasan Rrustemi, Basri Sallko e Maliq Balija, mori fjalen e tha se: Te perfaqesuarit prej meje Tahir deda, Fehim Ibrahimi, Abdullah Rexhepi, Hasan Rrustemi, Basri Sallko e Maliq Balija, të akuzuem per fajin e parapam prej ligjit, krimi kunder popullit e shtetit, per shkak se kanë qenë anëtar te komitetit ilegal ashtu quajtur Komiteti Demokratik Nacional, por nga rrjedhimi i gjykimit nuk u faqen prova për fajsin e tyre. Si fakt dhe provë per keto janë deponimet e njeni tjetrit qe ju ngarkojn akuzen gje qe nuk munt te konsiderohet si provë per denimin e tyre.

Tahir Deda ka dasht me formue nji komitet per kete ka bisedue me Fehim Ibrahimin dhe të pandehurit e tjerë veëse, skan pas marrë pjesë nate organizatë.

Kerkojm prej gjyqit qe te deklarohen te pafajshem ne rast denimi kerkojm qe tju nepet dënimi më i vogël.

Xhevdet Pallaska, përfaqësuesi mbrojtës i të i të pandehurve Rifat Krasniqi, Abdullah Hajrullahu, Abdullah Hamzës, Sinan Hazërit, Sefedin Ahmetit, Xhemil Flukut, Çamil Jeminit, Sadik Peçanit, Brahim Abdylit e Muhamet Vejselit, mori fjalë e tha se:

Shok gjyqëtar, para gjyqit te juaj ndodhen shumë persona me mjeshtrin dhe kapacitetet të ndryshme, kështu që në raste të dhanjes te vendimit per të pandehurit e përfaqësuem prej meje, lutemi gjithën te merret parasysh se organizata ku kanë marrë pjesë keta nuk ja ka mbrritun qëllimit.

Nji nga të përfaqësuesit e mij Rifat Krasniqi me emën "Sokrat Skenderbeg", sekretar i KND te Rahovecit, si e kemi konstatue dhe vet, ky të gjitha sendet gati i ka pohue, perveq se ka mohue te jet iniciator i Komitetit të Rahovecit.

Ky me të vërtet si nji intelektual dhe gjykatës na duket qe te jet iniciator, por vetem duhet të dijm se ne popullin tonë per deri tash njeri intelektual nga nji vend i huajne nji qytet si ai i Rahovecit nuk mund të luan role te kësi lloit pa e pas ndihmen e agallarve te vendit. Paries së vendit dhe pasanikve të vendit. Faji që e rëndon Rifatin ma tepër mund të jet se ky nuk asht kene dasht si intelektual me ra ne nji nivel- grad me anëtarët e tjerë te këtij komiteti.

Xhemil Fluku kryetar i komitetit qendrës së Prizrenit njeri i vogël dhe i lig ndoshta si i njohtun i kriminelit kapiten Riza Alisë ka ra nën influencen e tij i cili ka emnue si kryetar të këshillit kesh qe me padashje dhe jo koshiente asht kanë kryetar i organizatës ilegale.

Nga ana tjetër shofin se kete njeri te lig me rastin e grindjes qe janë bam ne vresht si kryetar, mbasi qe nuk ka tregue per komitetin as nji aktivitet, kështu pra shifet se asht kanë vegel qorre e kriminelit Riza Alisë dhe kukull ne komitetin qe mund te quhet komiteti i malit.

Abdullah Hamza "Paljaqo" njeri injorant ka ra viktim e ortakit te tij Sylejman Malltës, asht mashtrue dhe ka shkue bashk me te ne vneshta ke krimineliRiza Alia, po prej tij asht asht mashtrue dhe kjo bande. Ka bame nji konferencë ne shtepin e tij edhe ky asht betua, me dije qoft nga frika e influenca. Ndonji veprim dhe aktivitet ne kete komitet nuk asht bamun, por faje qe mund ti ngarkohen, asht se nuk i ka njohtue pushtetin popullor, por dhe këta e ka bamun nga injoranca, lutem gjyqit me e dënue me nji denim ma te lehtë.

Nji lloj me kete jep llogari para trupit gjykues dhe Abdullah Hajrullahu dhe ky mashtrohej e shkon ne vneshta, por si njeri paranderi, si njeri i varfën dhe kapiten Riza Aliu i nep shkelmin dhe nuk e lenë me u afrue ne rrethë. Ne vresht ku kanë pas konferencë nga kjo shifer se ky ka mundur me i shërbye vetem si korier e as gjë tjetër.

Te merret parasysh gjendja e tij ekonomike, injoranca dhe lutem qe te dënohet sa më leht.

Sefedin Ahmeti me që nuk ndodhet ketu, nuk kam çka te themë për te, pra gjyqi le të vendos çka te shofi të arsyeshme.

Sinanë Hazëri me duket se ka ngel si Miza në mjalt, gjykata kete gja mundet me e konstatue dhe keshtu kërkoj qe te lirohet nga akuza.

Persa i përket Qamil Eminit, Sadik Mehmet Peqanit sikurse është konstatue, keta kanë rënë viktim prej Tahir Dedës, të cilët kanë qenë tue ndejtun në kafe., janë thirrë prej Tahirit dhe kanë shkue ne shtepin e tij, mbasi ky ka qenë si nën [punës asht aq i poshtër që ta tradhtoi pushtetin popullor, ne shtepi ju ka folur dhe asht mundue me ju mbush mendjen, tue kritikue pushtetin dhe gjendjen e sotshme, por fjalet nuk kanë [pas sukses se keto megjith se si katundar dhe analfabet, me njëherë kanë pame se Tahiridonte ti fusi ne nji gjë kundra shtetit te cilen këta nuk e kanë deshirue dhe menjëherë janë largue, tue mos iu dhanë pëlqimin e vet. Mbi veti nuk kanë marr as nji detyrë as që kanë as që kanë bamun as nji veprim. Kjo keshtu forcihet me deponimet e të pandehurve te rreshtuem Maliq Balijes te cilat rezultojn te shenume ne procesin Gjyqësor të dt. 21 te këtij muaji.

Akuzat se këto ne vjetin 1943/44 gjoja kanë formue banda të armatosura kundra LNÇ nuk asht e vertet, por bashk me keto ky faj asht amnestuemun me Dekret ligjin mbi amnestin e faljen e përgjithëshme, shif art.1, pika 1.

Poashtu nuk asht e vertet se keta kanë mobilizue djelmosha per Divizionin SS, por përkundrazi brenda mundësive të tyre. LNÇ e kanë ndihmue deri diku bash tue pengue mobilizimin e djelmoshave per te shkue SS, por edhe ky faj me Dekretligjin e nalt permendun asht amnestue. I vetmi faj qe mund të retulltoj kundra tyre asht se keto nuk kanë lajmrue pushtetin popullor mbi fjalet qe ju ka thanë Tahiri, por edhe kjo ka rrjedhë nga injoranca e tyre dhe nga frika. Pra per keto kerkojm të shkarkohen nga akuza që e ngarkojn.

Ibrahim Abdyli nuk mund të merret nen përgjegjësi per te vetmen arsye se Tahir Deda i ka thanë Basri Sallkut se koriri te vjen Ibrahim Abdyli nga Peqni, ky asnjëherë nuk ka shkue e shërbye si korir, gjë e cila provohet me deklaratën e Basri Sallkos.

Muhamet Vejseli nuk ka bamun ndonji faj qe mund ta e rendojë ky ka qenë mik i lëvizjes NÇ. Kete gjë e ka provue se tue qenë okupatori këtu ka ik ne Krajkë, ku atje asht bashkue ne teritorin e lirë, me shokët Mehmet Hoxha e Nenadin, dhe tue qenë si mik asht zgjedhë si sekretar i Këshillit të Frontit, anëtar i Komitetit Shqiptar dhe kryetar ne katundin e vet dhe vet para popullit e shifni se sa turpnohet e i vjenë keq qe ndodhet para gjykatës, na duhet se nuk ka bame as nji faj.

Pra si për këtë asht dhe për të tjer[et kërkojm qe te shkarkohen nga akuza qe i ngarkohet.

I pandehuri Tahir Deda kur u pyet per herën e fundit rhase: Kekrojë mëshir prej trupit gjykues per gabimet qe kam bame, tue shtuem, se nuk është bamue ndonji vepër e keqe dhe se nuk kemi pas qellim te kete.

I pandehuri Halim Spahija tha se: Unë kam qenë i LNÇ qysh nga vjeti 1941, kamë dhanë ndihmat e mija morale dhe materiale. Fjala e bamun prej të pandehurit Tahir se organizata e tyre e ka pas kryet në Kukës, nuk donë me thanë se jam une , per shkak se une nuk mundem ta përfaqësoi Kukësin. Familja ime si si nji familje partizane ka pas njerëz të internuem ne Vjenë, unë kam qenë de jam nji person i LN. Tahir Deda ka pohue para meje se une nuk i kam dhanë udhëzime. Kukësin une sikur që thash nuk mundem me e përfaqësue i cili asht 20.000 frymë dhe unë nuk jam kene ndonji bajraktar ose kryetar i Kukësit. Sjelljet e mija i dijn të gjithë dhe ne se nuk do të bihet knaqesia te pyetet Kukësi, Prizreni dhe Gjakova. Kërkoj që të vendoset shkarkimi i em nga akuza dhe në rast te kundërt, kërkoi qe te lehtësohem ne ndëshkimin që mund te me jepet.

I pandehuri Fehim Ibrahimi tha se: Une nuk kam bame pjesë ne komitet dhe ne mbledhje dhe asnjë detyrë te caktueme nuk kam pas dhe gjithë pjesëtarët e familjes se ime kanë ndihmue luftën NÇ dhe shtëpia e ime ka qenë çerdhja e partizanëve , kërkoi pafajs e në rast të kundërt lehtësimin e ndëshkimit.

I pandehuri Hasan Rrustemi tha se: Unë vetem jam fajtor per shkak se nuk kam lajmrue autoritetet, por kjo ka rrjedhë per shkak te traditave shqiptare pse kanë qenë miq në shtëpie dhe kërkoi pafajin e vet.

I pandehuri Basri Sallko thase, unë jam i pafajshëm dhe kërkoi pafajin e vet.

I pandehuri Maliq Balija thase unë nuk kam organizue gja ne Rahovec, veq se jam njeripa influencë dhe kërkoi qe te vendoset pafajësia e tij.

I pandehuri Rifat Krasniqi th ase: Ndodhem para Gjyqit Popullor dhe popullit si fajtor se gjoja unë kam formue Komitetin Nacional Demokratik në Rahovec. Nga nji deklarat e nji profesori te universitetit kame pamun raste me pa se si une jam futun si njiintelektual ne nji organizat te tillë, gjyqi kur të gjykoj e nji njeriut, duhet me hetue gjanë e gjatë. Hoxhë Maliqi ka deklarue se kur ka qenë në Rahovec atje asht takue me Kadri Minushin e i ka kërkue listen per me formue komitetin.

Shok gjyqëtar si vetë nji person pa kene në komitet per me kerkue listat, kete mund ta gjykoni juve.

Jo vetem si nji student kur kam qenë në Beograd, kam bame pjesë në LNÇ, por edhe gjatë kohës së okupacionit kam fillue me kërkue shokë antifashista dhe mbasi jemi formue e kemi bamun shoqënin e kemi nxjerr pllakata e mbas pak kohe jemi lidh me Prizrenin qe ne te ishte Xhavit Nimani si kryetar e tue bashkpunue me te e ma vonë me Ismet Shaqirin dhe keshtu kam punue tue dhanë dhe ndihmat e nevojshme, ne shtepi kam mbajtur partizan dhe kam shpetue jeten e pesë partozanve si Ramadan Vraniqiit e të tjerë. Keshtu kam ndërhy dhe kam shpetue tue i marr ne dorëzim nga duert e gjandarmerisë, kur ndodhesha si gjyqëtar te cilet kanë pas listen e shumë shokëve te cilën e kam grisur, per mos me ra në në dorë të okupatorit.

Të gjithëa këto kërkoj qe te merren parasysh dhe të deklarohem i pa fajshëm, ose ma ne fund te shumten e fajit me amnistie, mbasi neve nuk kemi bame ndonji luftë dhe as duret nuk i kemi të lyme me gjak.

**(Vijon)**



armeve dhe te materjalit tjeter per bandat ne mal dhe gjykata ja ka marre si shkaqe lehtesore pohimin e saje, pendimin e saje rrethanen se si e re asht mashtrue dhe ka hie n'organizaten ilegale e ka denue me denimin e humbjes te liries, pune te perdhunueshme me vashdim prej nji vjeti.

Se e pandehuna [illegible] Rjeda ka qene antare e komitetit te n[illegible]-lte permendun dhe nji koneishte ka qene ne S.K.O.J., se si antare e Komitetit ka mbeledhe materjal per bandat dhe gjykata, tue ja marre parasyesn si shkaqe lehtesore, pohimin e sajependimin e saj, vepren e saje te vegel ne komitet dhe faktin se si e re asht mashtrue ka hie ne komitetin enalte permendun e ka denueme me humbje e liries, me punim te detyrueshem te vashdyem prej nji vjeti.

Se e pandehuna Nesibe Zhuri ka qene antare dhe arketare e organizates te nalte permendun ilegale, se ka punue ne mbeledhjen e materijalit, se Gjykata, tue ja marre para syesh si shkaqe lehtesore, pohimin e saje, pendimin e saje, perpjekjet e saja qe [illegible] te skarohet dhe faktin se si e re ka ra nen influencen e vllaut te vete, dhe se, prej dashtuenies qe kishte per to, ka hie ne organizaten ilegale, qe me anen e kesaje rruge t'a e ndihmonte materialisht e ka ndeshkue me humbjen e liries, me punim te detyrueshem per nji vjete, ndeshkim i cili asht kondicionel dhe i pezullueshem per nji vjete kohe, tue e konsiderue se ky ndeshkim asht i mjaftueshem me enkaktue ne te positivishte dhe me u permirsue, keshtu qe ne t'ardhesshmen do te mbanet ne kruemjen e kesi lloj fajesh.

Se e pandehuna Resa Cuki, ka qene antare e komitetit, [illegible] qene aktive ne pune, se detyren e ngarkuem per mbeledhjen e materjalit nuk e ka krye pletsishte, dhe Gjykata tue ja marre para s[illegible] rrethana lehtesore pohimin dhe pendimin - e ka denue me nji vjete te humbjes se liries, me punim te perdhunueshem, ndeshkim i cili asht kondicionel dhe i pezullueshem per nji vjete kohe, dhe tue i konsiderue se ky ndeshkim asht i mjaftueshem me enkaktue te positivishte dhe me u permirsue.

Gjykata nuk ka mund me konstatue se, te pandehunat [illegible] Krasniqi, [illegible] Gjoka, [illegible] Shyti kane bame pjese dhe kane qene antare te komitetit ilegal te nalte permendun [illegible]

[illegible]

## May nuk tërhiqet nga mbështetja për marrëveshjen për Brexitin

LONDËR, 16 NËNTOR - Kryeministrja britanike Theresa May i doli në mbrojtje projekt-marrëveshjes së saj të debatueshme për çështjen Brexit, duke i bërë thirrje publikut britanik ta mbështesë atë.
Kritikët brenda partisë, të cilët ankohen se marrëveshja e propozuar do ta kthejnë Britaninë në një "shtet vasal", përgatitën ndërkohë një kërkesë zyrtare për largimin e May.
Marrëveshja e propozuar me Bashkimin Evropian, më shumë se dy vjet pasi britanikët votuan në një referendum për të dalë nga blloku, shkaktoi dorëheqjen e 6 ministrave. Marrëveshja u bë gjithashtu shkak për një situatë tensioni të lartë në Dhomën e Komunave, ku kryeministres iu bë pritja më armiqësore që një kryeministër ka pasur që nga viti 1940, kur Neville Chamberlainin e detyruan të largohej nga detyra, në fillim të Luftës së Dytë Botërore.
Gjatë një interviste në radio, May tha se ka negociuar marrëveshjen më të mirë të mundshme, pavarësisht se janë kaluar shumë "vija të kuqe" të vendosura më parë prej saj. May dhe besnikët e saj thonë se nuk ka alternativë tjetër veç marrëveshjes së propozuar prej rreth 538 faqesh, fryt i bisedimeve të vështira. Sipas tyre alternativat do të ishin edhe më të pakëndshme për Britaninë ose të pamundura që BE-ja të mund t'i pranonte.
Barra e kryeministres u lehtësua të premten, kur një ministër i lartë, Michael Gove, i përfolur se do të jepte dorëheqjen në shenjë proteste ndaj marrëveshjes, tha se do të qëndronte në kabinetin qeveritar.



# Republikanët dhe demokratët përqendrohen te gara presidenciale e 2020-s

Ende pa përfunduar numërimi i votave të zgjedhjeve të 6 nëntorit për Kongresin, dy partitë e mëdha politike janë përqendruar tashmë në sfidën e ardhshme - betejën presidenciale të vitit 2020



UASHINGTON, 16 NËNTOR - Në ShBA, edhe pse vazhdon numërimi i votave në disa prej garave që ishin pjesë e zgjedhjeve të 6 nëntorit për Kongresin, dy partitë e mëdha politike janë përqendruar tashmë në sfidën e ardhshme - betejën presidenciale të vitit 2020.
Në një konferencë shtypi pas zgjedhjeve, presidenti Donald Trump u përpoq t'i përshkruante me një ton pozitiv rezultatet, të cilat bënë që demokratët të merrnin kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve për herë të parë pas tetë vjetësh. "Kjo ishte një fitore e madhe për ne. Nga pikëpamja e asaj që arritëm, ne të gjithë kemi dalë më të fituar, sepse unë vërtet besoj se nëse demokratët dëshirojnë, ne mund të kalojmë shumë ligje të rëndësishme", tha ai.
Me ndihmën e presidentit Trump, republikanët e rritën paksa shumicën e tyre në Senat.
Por demokratët i shohin rezultatet e zgjedhjeve të këtij viti si një shenjë paralajmëruese për presidentin, ndërsa ai përgatitet të kandidojë për t'u rizgjedhur në vitin 2020. "Republikanët humbën votueset gra, pakicat dhe votuesit periferikë në të gjithë vendin në një shkallë të tillë saqë kjo duhet të shqetësojë çdo kandidat republikan në zgjedhjet e vitit 2020 ashtu si edhe presidentin Trump", tha Chuck Schumer udhëheqësi i pakicës demokrate në Senat.
Presidenti Trump ishte faktor kyç në zgjedhjet e këtij viti për votuesit e të dyja partive, thotë analisti John Fortier. "Donald Trump doli shumë mirë në shtetet republikane, në zonat rurale, në qytete më të vogla. Por demokratët fituan më tepër në zonat nënurbane, ku votuesit e bardhë dhe më të arsimuar votuan me shumicë kundër tij", tha ai.
Sfida për demokratët tani është gjetja e një balance midis bashkëpunimit me presidentin dhe hetimit ndaj administratës së tij, thotë analisti Larry Sabato. "Ata siguruan një fitore deri-diku, por kjo nuk i ngjan aspak asaj të republikanëve në vitin 2010. Dhe nëse demokratëve nuk u kujtohet kjo, atëherë ata do të jenë në kontroll të Dhomës së Përfaqësuesve vetëm për dy vjet dhe pastaj Trumpi do të rizgjidhet, duke i sjellë republikanët përsëri në pushtet", tha Sabato.
Demokratët fituan disa gara të rëndësishme për guvernatorë dhe kjo mund t'i ndihmojë ata në betejën presidenciale të vitit 2020, thotë Jim Kessler. "Demokratët fituan në shtetet ku në vitin 2016 kishte fituar Trumpi. Në Miçigan, në Uiskonsin dhe në Pensilvani, demokratët arritën të zgjedhin politikanë të moderuar për guvernatorë. Muri blu i demokratëve që u shkatërrua në vitin 2016 po ndërtohet përsëri, nëse demokratët emërojnë njeriun e duhur në vitin 2020", tha Kessler.
Në janar, balanca e pushtetit në Uashington do të ndryshojë dhe demokratët do ta marrin kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve. Në të njëjtën kohë, demokratët i kanë hedhur sytë drejt vitit 2020 dhe procesit të përzgjedhjes së një kandidati presidencial i cili do të përpiqet t'i mohojë presidentit Trump një mandat të dytë katërvjeçar.

## BE-ja alarmohet pas arrestimit të akademikëve dhe aktivistëve në Turqi

ANKARA, 16 NËNTOR - Policia turke ka ndaluar 13 persona, duke përfshirë dy akademikë të mirënjohur në hetimet rreth aktivistit të burgosur, Osman Kavala, nën akuzat se ata kanë përkrahur atë kur ai ka synuar ta rrëzojë qeverinë në protestat masive të vitit 2013, transmeton "Reuters".
Kavala, lider i njohur i shoqërisë civile, është arrestuar një vit më parë dhe është duke pritur gjykimin rreth tij, pasi autoritetet turke kanë vlerësuar se këto protesta kanë qenë vazhdimësi e tentimeve të dështuara për grusht shtet në korrik të vitit 2016.



Policia ka thënë se personat e arrestuar të premten janë akuzuar se kanë punuar me Kavalën në protestat e vitit 2013. Të paktën 10 persona kanë vdekur dhe mijëra të tjerë janë plagosur në këto protesta, të cilat në atë kohë kanë qenë protestat më masive kundër Qeverisë së kryeministrit të atëhershëm, tani presidentit të Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, duke treguar pakënaqësi për hyrjen në dekadën e dytë të tij si kryeministër.
Bashkimi Evropian ka shprehur shqetësim lidhur me ndalimin e akademikëve dhe aktivistëve për të drejtat e njeriut duke kërkuar lirimin e tyre të shpejtë. "Ndalimi i disa akademikëve të mirënjohur dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile këtë mëngjes është alarmant", ka thënë Shërbimi i Bashkimit Evropian për Veprim të Jashtëm, në një deklaratë.

# Vitamina D dhe tumoret, cila është lidhja?

Disa kërkime pohojnë se nivelet e larta të vitaminës ulin shanset e kancerit, të tjerë thonë se nuk ka dëshmi. E vërteta është shpjeguar nga një onkolog

Një studim ndërkombëtar i kohëve të fundit i krijuar nga bashkëpunëtorët e hulumtuesve europianë, amerikanë dhe aziatikë, botuar në 'Journal of the National Cancer Institute', ka dalë në përfundimin se niveli i lartë i vitaminës D në gjak mbron kundër tumorit më të zakonshëm në Itali, atë të zorrës së trashë-rektumit. Sipas një studimi tjetër në revistën shkencore 'Jama Oncology', plotësimi mujor i dozës së lartë të vitaminës D nuk lidhet me zvogëlimin e incidencës ose vdekshmërisë për lloje të ndryshme të kancerit. Atëherë, cila është e vërteta? Dhe pse flitet shpesh për përfitimet e vitaminës D? Është pyetur Antonio Russo, profesor i onkologjisë mjekësore në Universitetin e Palermos dhe anëtar i bordit drejtues të Shoqatës Italiane të Onkologjisë Mjekësore (Aiom).

## Cilat janë përfitimet e vitaminës D për shëndetin tonë?

"Vitamina D është një substancë organike e nevojshme për të gjitha organizmat e kafshëve për funksionimin normal të proceseve vitale, – shpjegon Russo. – Ajo merret nga ushqimi dhe prodhohet kur lëkura është e ekspozuar ndaj dritës së diellit. Veprimi i vitaminës D është promovimi i përthithjes së kalciumit në nivelin e zorrëve për ta drejtuar atë në funksionet e tij të ndryshme. Ndër më të njohurat, ne e dimë se nivelet adekuate të vitaminës D janë thelbësore për mirëmbajtjen e mineralizimit të kockave optimale me një rol të pazëvendësueshëm në parandalimin dhe trajtimin e osteoporozës post-menopauze dhe senile. Vitamina D është gjithashtu e rëndësishme për sistemin imun dhe muskujt, ashtu edhe në shtatzëni si për nënën, edhe për fetusin. Së fundi, është treguar gjithashtu se mungesa e vitaminës D mund të lidhet me zhvillimin e depresionit, rënien e funksioneve njohëse dhe çrregullimet kardiovaskulare".

## Si e marrim vitaminën D në trupin tonë?

"Vitamina D merret kryesisht me ushqime të tilla si qumësht, djathë, kos, vezë (vezë e verdhë), mëlçi viçi, vaj i mëlçisë së kokës, drithërat e mëngjesit dhe peshku (sardelet, peshk shpatë, ton dhe salmon sidomos), – thotë eksperti. Ekzistojnë edhe substanca të tjera si curcumin, brassicaceae (lakër), acide yndyrore omega 3 që mund të promovojnë efektet e vitaminës D. Përveç kësaj, ekspozimi ndaj dritës së diellit është burimi kryesor i prodhimit të vitaminës D, aq shumë sa që ekspozimi ndaj diellit që shkakton një skuqje të lehtë të lëkurës është e barabartë me marrjen gojore të vitaminës D për rreth 10 mijë njësi ndërkombëtare në ditë. Duhet marrë në konsideratë se kërkesa ditore e vitaminës D për të rriturit llogaritet në rreth 400-800 njësi në ditë dhe se ushqimi në Itali furnizon rreth 300 njësi në ditë".

## Çfarë është shkencërisht e sigurt në lidhje me këtë vitaminë dhe kancerin?

"Lidhja në mes vitaminës D dhe kancerit është studiuar shumë edhe pse pyetja mbetet e diskutueshme dhe e debatuar sot, – përgjigjet Russo. – Ndërsa disa prova shkencore sugjerojnë se nivelet e larta të vitaminës D mund të zvogëlojnë rrezikun e kancerit (sidomos prostatës, zorrës së trashë dhe gjirit), të dhëna të tjera duket se shkojnë kundër kësaj ideje. Në fakt, duke lexuar mirë mes linjave, shumë autorë konvergojnë në faktin se efektet e vitaminës D mund të ndryshojnë në varësi të dozës së marrë. Në veçanti, duket se shumë nga përfitimet e siguruara nga vitamina D do të humbeshin kur merren në doza tepër të larta".

## Si përfundim, çfarë rekomandohet të bëjmë?

"Nivelet e sakta të vitaminës D janë të rëndësishme për ruajtjen e shëndetit të një individi, si në fëmijëri ashtu edhe në moshë madhore, – thekson Russo. – Deri më sot, megjithatë, nuk ka asnjë konsensus të vetëm për atë që është formulimi më i mirë për t'u rekomanduar. Ajo që është e sigurt është se individët me nivele të ulëta të vitaminës D duhet të marrin një shtesë të dobishme për të arritur vlerën e saktë të synuar të rekomanduar për çdo grupmoshë sipas udhëzimeve ndërkombëtare, duke përfshirë zgjedhjen e mjekut të tyre. Natyrisht, është e këshillueshme që të merrni ushqim të pasur me vitaminë D, si dhe një ekspozim të arsyeshëm ndaj rrezeve të diellit".

*(gazeta-Shqip.com)*



E jashtëzakonshme

## Stafi shpërblehet me pushkë dhe pistoleta



Ben Wolfgram, pronar i një kompanie që prodhon gota të deformuara nga një plumb, i ka shpërblyer punonjësit e vet për Krishtlindje jo me para, por me armë. Ai u ka dhënë nga një kupon, me të cilin punonjësit kanë të drejtë të blejnë çfarë arme të duan, veçse më parë duhet të kenë ndjekur kurs profesional për përdorimin e armës.

FOTO E DITES



Një kope zogjsh shihen afër një vinçi në Milano të Italisë. /AP/

E rrallë

## Pesëvjeçari fiton Mercedesin 30 mijë euro



Një pesëvjeçar fitoi një Mercedes Benz nga presidenti i vendit të tij pasi bëri 4 105 pompa. Vogëlushi muskulor çeçen, Rahim Kuriev, i quajtur "Shvarcenegeri çeçen", fitoi një Mercedes Benz që kushton rreth 30 mijë euro, të dhuruar nga udhëheqësi i vendit të tij, Ramzan Kadirov. Kuriev është i fiksuar që tani me ushtrimet fizike dhe trupi i tij e tregon këtë më së miri. Ai kishte vendosur një rekord botëror duke bërë 4 100 pompa, por nuk u njoh si i tillë.

## BARSOLETA E DITËS



**Një vajzë po mbush një fjalëkryq me babanë e vet:**
**- Ç'është fundi i jetës? Duhen shtatë shkronja.**
**- Martesa, i përgjigjet babai.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

### "ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

**Vetem gjate vikendit në ora 14:00**







Në ora 16:00

### "JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

**Rolet:** Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
**Regjia:** David Kerr

Në ora 18:00

### "NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
**Regjia:** Malcolm D. Lee







Në ora 20:00

### "SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

**Rolet:** Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
**Regjia:** Matthew Ross

Në ora 22:00

### "VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

**Rolet:** Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Ankthi që kishit për ditën e sotme do të zvenitet shumë shpejt. Pa e menduar do të arrini të mbaroni punë që në orët e para të ditës.



**DEMI**
Jeni të shqetësuar se çfarë do të ndodhë me një problem të caktuar tuajin, por nuk e kuptoni që po i fusni vetes energji negative pa ndodhur asgjë.



**BINJAKËT**
Nëse mendoni që sot duhet t'ju realizohet gjithçka pa bërë asnjë lëvizje, gaboheni rëndë. Impenjohuni nëse doni të keni rezultate.



**GAFORRJA**
Edhe pse një ditë e zakonshme, ju nuk bini asnjëherë pre e rutinës, por dini si të organizoni takime dhe aktivitete që ju vënë në lëvizje.



**LUANI**
Keni mjaft opsione interesante sot për ta kaluar ditën dhe nuk dini kë të zgjidhni. Miqtë duan një ditë në natyrë dhe vendi do t'ju pëlqejë pa masë.



**VIRGJËRESHA**
Ilaçi i ditës tuaj sot do të jenë blerjet. Ata që ju shoqërojnë do të kënaqen sepse ju bëni shumë dhurata.



**PESHORJA**
Sot jeni ju protagonistët e situatave të ndryshme që ju ofron dita. Do të dini t'i bëni zgjedhjet e duhura.



**AKREPI**
Edhe pse dita do të jetë shumë e rrëmujshme, mbrëmja paraqitet e qetë dhe në shoqëri të mirë.



**SHIGJETARI**
Partneri nuk do të kuptojë një takim pune që do t'ju dalë sot papritur. Debate dhe zënka parashikohen gjatë pasdites.



**BRICJAPI**
Keqkuptimet që do të lindin së fundmi nuk do të ndodhin për shkakun tuaj, kështu që nuk keni pse të ndiheni fajtor.



**UJORI**
Mos qëndroni të mbyllur në shtëpi sot. Dita është shumë e bukur dhe duhet shijuar në çdo çast. Do ta kërkoni shoqërinë e një miku.



**PESHQIT**
Sot çdo gjë duket sikur shkon sipas planit dhe nuk do të ndiheni të rrezikuar aspak nga një koleg që ju ka vënë shkopinj nën rrota.

# Toni Braxton mund të martohet brenda disa javëve



Për vetëm disa javë Toni Braxton mund të jetë një grua e martuar. Duke folur për Wendy Williams, 51-vjeçarja Braxton ka thënë se ajo dhe i fejuari i saj, reperi Birdman, tashmë kanë vendosur dy data për dasmën e tyre, por që asnjëra nuk i janë përshtatur. "Ai më ka thënë të vendosë një datë para se të përfundojë ky vit. Kam disa javë kohë", ka vazhduar këngëtarja e shumë hiteve, Braxton.

# The Weeknd dhe Bella Hadid tashmë jetojnë bashkë



Bella Hadid dhe The Weeknd janë duke jetuar tashmë së bashku. "Ai e ka ftuar që të jetojnë së bashku dhe ajo, pa dyshim, ka pranuar. Ajo e ka ndjerë se ky ishte hapi më i mirë dhe i duhur në lidhjen e tyre të dashurisë", ka thënë një burim pranë çiftit për revistën "Us Weekly". Këngëtari 28-vjeçar dhe supermodeluesja 22-vjeçare kishin njoftuar se janë ndarë në muajin nëntor të vitit 2016.



# Kendall Jenneri shkëlqen me veshjen

Modeluesja e "Victoria Secret", Kendall Jenner, mori pjesë në ndejën e organizuar nga Charlotte Stockdale dhe Katie Lyall në barin "The Baptist Bar L'Osca" në Londër. Jenner edhe këtu u shfaq si herëve të tjera me një veshje interesante. Ajo pati të veshur një fustan ngjyrë portokalli, të cilin e shoqëroi me një palë këpucë të tejdukshme.

# Zayn Malik konfirmon se nuk e konsideron veten më mysliman

Këngëtari dhe modeli Zayn Malik ka konfirmuar se ai nuk identifikohet më si mysliman. Në një intervistë të dhënë së fundmi për "British Vogue", ish-këngëtari i 'One Direction', 25-vjeçar, ka thënë se ai nuk është më mysliman praktikues dhe nuk beson në asnjë fe. "Unë nuk jam deklaruar ndonjëherë si mysliman", është shprehur ai. Kur është pyetur nëse e konsideron veten mysliman, ai u përgjigj: "Jo, unë nuk do të jem më i tillë".






# Sport




| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ACCRINGTON STANLEY - BARNSLEY | 1 | FLEETWOOD TOWN - WALSALL | 1 | LUTON - PLYMOUTH | 3+ |

# Kosova për kualifikimin ndaj Maltës

"Dardanët" synojnë maksimumin e pikëve ndaj Maltës dhe kualifikimin në 'play-off' të Ligës së Kombeve. Ndeshja zhvillohet sot nga ora 18:00, kurse Kosova është favorite absolute për ta fituar ndeshjen ashtu sikurse një muaj më parë në Prishtinë. Trajneri Bernard Challandes ka thënë se moskualifikimi tutje i Kosovës do të ishte një dështim i madh, por jo edhe fundi i botës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Më 11 tetor në stadiumin "Fadil Vokrri" përfaqësuesja e Kosovës e kishte mposhtur Maltën, kurse të njëjtën gjë synon ta bëjë edhe sot (e shtunë) në Valleta dhe në këtë mënyrë ta sigurojë kualifikimin për fazën tjetër në Ligën e Kombeve.
Sulmuesi Vedat Muriqi ka thënë se "Dardanët" duhet ta sigurojnë kualifikimin në Maltë, kurse tri ditë më vonë në ndeshjen ndaj Azerbajxhanit në Prishtinë ta festojnë kualifikimin. "Presim të kualifikohemi tutje dhe jemi shumë optimistë për këtë. Besoj se do të arrijmë të përgatitemi mirë dhe ta arrijmë kualifikimin qysh në Maltë, pastaj të kthehemi në shtëpi kundër Azerbajxhanit për festë", ka thënë Muriqi.
Më i matur në deklaratën për kualifikimin ishte treguar trajneri Bernard Challandes, i cili mendon se edhe nëse nuk kualifikohet Kosova tutje, nuk do të ishte fundi i botës. "Për ne aktualisht është e rëndësishme ta arrijmë kalimin në 'play-off' të Ligës së Kombeve. Po ashtu, nuk do të jetë fundi i botës nëse Kosova nuk do të kualifikohet. Normalisht se do të ishte zhgënjyese nëse nuk do të kualifikoheshim në gjysmëfinale të Ligës së Kombeve, mirëpo ne duhet të mendojmë për të ardhmen dhe ta vazhdojmë procesin e ndërtimit të ekipit dhe të shohim se çfarë do të sjellë e ardhmja", kishte deklaruar Challandes.



Përfaqësuesja e Kosovës në kualifikimet ka qenë mjaft e mirë duke grumbulluar tetë pikë nga katër ndeshje. Ndërsa një nga lojtarët më të mirë në ekipin e Kosovës, Valon Berisha, i cili aktivizohet me skuadrën e Lazios në Serinë A, ka thënë se futbollistët do ta japin 100-përqindëshin që Kosova ta realizojë objektivin. "Kemi lojtarë shumë të mirë dhe po përgatitemi mirë. Sigurisht se kemi dy ndeshje shumë të vështira para vetes, sidomos kjo kundër Maltës. Shumëçka do të varet nga mentaliteti ynë në këto dy ndeshje. Ne kemi cilësi si ekip dhe me individë shumë të mirë dhe do të shkojmë me synimin për ta dhënë 100-përqindëshin për njëri-tjetrin dhe për Kosovën", ka thënë Berisha.
Stërvitjen e fundit para ndeshjes, Kosova e zhvilloi të premten nga ora 18:00 në Valleta.

### Sermaxhaj: Kosova favorite, pa humbje që një vit

Ish-reprezentuesi i Kosovës dhe tash analisti i futbollit, Genc Sermaxhaj, ka thënë për "Epokën e re" se Kosova është favorite për ta kaluar grupin. Sipas ish-lojtarit të Prishtinës, Dritës dhe Gjilanit, përparësi e "Dardanëve" në këto dy ndeshje është fakti se nuk kanë pësuar humbje që një vit. "Kemi zhvilluar ndeshje shumë të mira dhe nuk kemi humbje tash e një vit. Duhet të vazhdojmë njësoj me po të njëjtën qasje. Jemi favoritë. Jemi përfaqësuesja më e mirë e grupit. Duhet të kalojmë tutje, por vetëm me angazhim dhe disiplinë në lojë dhe jashtë saj, ndryshe mund të hasim në pengesa të ndryshme që mund të na bëhen pengesë për formën dhe rezultatet pozitive", ka thënë Sermaxhaj.

### Kosova, favorite e madhe nga kompanitë e basteve

Ndeshja e parafundit e Kosovës në Ligën e Kombeve është ndaj Maltës në Valleta. Edhe kompanitë e basteve e shohin përfaqësuesen e drejtuar nga Bernard Challandes si favorite për të fituar këtë ndeshje. Shumica e bastoreve, si "bet & win", "paddy poker" ia kanë dhënë Kosovës koeficientin 1.50, kurse Maltës 9.00.

# Krasniqi fitoi medaljen e bronztë në Hagë

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Distria Krasniqi ka shtuar një tjetër medalje në sirtarin e vet, të dytën brenda një jave. Këtë herë, nënkampionia e Evropës fitoi të bronztën në Grand Prixin e xhudos, që po mbahet në Hagë të Holandës. Distria fitoi të bronztën në kategorinë deri 48 kilogramë, kurse në konton e vet shtoi edhe 350 pikë olimpike. Pra, kjo garë vlen për pikë kualifikuese në Lojërat Olimpike "Tokyo 2020". Në luftën për të bronztën përmes repesazhit, Distria mposhti kinezen Yanan Li për më pak se 20 sekonda. Në përgjithësi, ajo shënoi katër fitore dhe një humbje në çerekfinale nga japonezja Aya Sakagami. Akil




Gjakova (-73 kg) garon nesër (e shtunë) dhe Loriana Kuka (-78 kg) garon të dielën. Majlinda Kelmendi dhe Nora Gjakova nuk kanë marrë pjesë në këtë Grand Prix.



# Vazhdon dominimi i 'Epokës së re' në Media Ligë

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Ekipi i gazetës "Epoka e re" ka vazhduar dominimin edhe pas xhiros së dhjetë në Media Ligë, pasi në ndeshjen e parë të kësaj jave e ka mposhtur ekipin e "Kallxo.com" me rezultat bindës 8-0. "Epoka..." që nga fillimi i ndeshjes e deri në fund ishte ekip më i mirë se kundërshtari dhe në këtë mënyrë e ruan kryesimin dhe mbetet ekipi i vetëm i pamposhtur në ligën e medieve, kurse prej dhjetë ndeshjeve të zhvilluara ka regjistruar tetë fitore dhe dy barazime.

## Futbollistët e Flamurtarit do të paguhen javën që vjen

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Shumica e futbollistëve të Flamurtarit vazhdojnë të mos paguhen prej më shumë se dy muajsh. Për këtë arsye, lojtarët kishin bojkotuar dy seanca stërvitore para dy javësh. Megjithatë, edhe pse kanë kaluar gati 14 ditë, pjesa dërrmuese e futbollistëve ende nuk kanë marrë centin. Por, pritjeve, si duket, po u vjen fundi, shkruan "Gazetasheshi.com", e cila merr vesh se kryetari i klubit ka arritur t'i sigurojë mjetet dhe gjatë javës së ardhshme do t'u shlyhen të gjitha borxhet futbollistëve. Flamurtari ka pasur rezultate relativisht të mira këtë edicion.

## Grezda krahason Shqipërinë me "fortesën" e rangersave



TIRANË, 16 NËNTOR - Futbollisti i Rangersit, Eros Grezda, i cili në fundjavën e shkuar ishte spektakolar në fitoren 7-1 ndaj Motherwellit, e priste me padurim këtë përballje ndaj Skocisë për hakmarrjen e humbjes 2-0 në Glasgou. Në një prononcim të bërë për mediet skoceze, "www.dailyrecord.co.uk", ai e ka krahasuar Shqipërinë si një farë "Ibrox Stadium" në Glasgou, pra shtëpia e Rangersit. "Në Glasgou u mundëm sepse kishim shumë mungesa dhe lojtarë jo në formë, por tani do të jetë ndryshe. Pastaj, kur luajmë në vendin tonë transformohemi. Shqipëria është njësoj si stadiumi i klubit ku luaj, Rangers, pra Ibrox Stadium. Aty askush nuk na mund", ka thënë Grezda. Sa iu përket shanseve në grup, Grezda ka deklaruar: "Ne do ta kërkojmë fitoren për të mos rënë një ligë më poshtë, pastaj nëse fitojmë 3-0 aq më mirë. Objektivi kur nisi Liga e Kombeve nuk ishte ky, por tashmë duhet të fokusohemi vetëm në këtë ndeshje".

# Gashi: Sporti i paraglajdizmit të promovohet sa më shumë në Kosovë



PRISHTINË, 16 NËNTOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka takuar përfaqësuesit e Klubit Aeronautik "Ballona e Sahit Ukës", me të cilët ka diskutuar për paraglajdizmin dhe për aktivitetet që realizohen në këtë sport jo aq të përhapur në Kosovë.

Ministri Gashi i ka inkurajuar përfaqësuesit e Klubit "Ballona e Sahit Ukës" që t'i rrisin edhe më shumë aktivitetet dhe pjesëmarrësit në këtë sport dhe ta promovojnë atë sa më shumë në vendin tonë dhe për këtë kanë përkrahjen e plotë të ministrit dhe të MKRS-së. Ministri është shprehur se ndër objektivat e tij si ministër është masivizimi i sportit në përgjithësi si dhe ky është një prej prioriteteve të MKRS-së sa i përket fushës dhe politikave në sport. "Duam që në Kosovë të kemi përqindje më të lartë të qytetarëve, e veçmas të të rinjve tanë për të qenë pjesë e aktiviteteve sportive", ka thënë ministri Gashi.

Ndërkaq përfaqësuesit e "Balona e Sahit Ukës" kanë falënderuar ministrin për pritjen dhe përkrahjen e ofruar. Ata e njoftuan ministrin për planet dhe për aktivitetet që janë duke i realizuar si dhe për objektivat që kanë në të ardhmen.

# Houstoni, 'leksion' kampionëve të Golden State




HOUSTON, 16 NËNTOR - Mungesa e Stephen Curryt vazhdon të ndihet te skuadra kampione e Golden State, që u mposht 107-86 nga Houstoni në takimin e radhës në NBA, humbja e katërt sezonale për Warriorsin. Një ndeshje e dominuar nga vendësit, me James Hardenin që bëri diferencën në fushë, autor i 27 pikëve, ndërkohë që edhe stoli dha një dorë në këtë triumf, nga ku erdhën 38 pikë. Për mysafirët u dallua Duranti me 20 pikë, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Fiton ekipi i Clippersit, që mundi 116-111 San Antonio, një përballje mes dy ekipesh rivale në Perëndim, ndeshje në përgjithësi e dominuar nga vendësit, që në fund rrezikuan disi. Williamsi me 23 pikë ishte shënuesi më i mirë për vendësit, mbështetur edhe nga Gallinari (19) e Harrisi (18), ndërsa për Spursin u dallua DeRozan me 34 pikë, por që mbetën për statistikë. Ekipi i Denverit, falë 25 pikëve të Hernangomes, mundi 138-93 Atlantan, ndeshje ku 7 lojtarë të ekipit vendës realizuan mbi 12 pikë.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Houston - Golden State | 107-86 |
| Denver - Atlanta | 138-93 |
| Clippers - San Antonio | 116-111 |

## SHKURT

### Federata e Gjimnastikës, gara për festat e nëntorit

Federata e Gjimnastikës e Kosovës ka njoftuar se sot (e shtunë) fillojnë garat nga gjimnastika artistike për femra dhe meshkuj. Garat parashihen të mbahen tri ditë, ku të shtunën nga ora 10.00 do të bëhen kualifikimet për femra, të dielën në të njëjtën kohë kualifikimet për meshkuj si dhe të shtunën e ardhshme do të jetë finalja e madhe e cila do t'i përcaktojë fituesit në disiplinat e gjimnastikës artistike. Ky aktivitet organizohet për t'i nderuar festat e nëntorit.

### Alba në vend të Sandros në Juve

Juventusi planifikon transferimin e një mbrojtësi të majtë. Fillimisht ishte synuar transferimi i Marcelos nga Reali i Madridit, por një transferim i tillë duket i vështirë për faktin se brazilian është i lumtur në "Santiago Bernabeu". "Corriere dello Sport" raporton se tash "Zonja e Vjetër" e ka në shënjestër Jordi Alban e Barcelonës, i cili ka kontratë me këtë klub deri në vitin 2020. Alba shihet si një zëvendësim ideal për Alex Sandron, i cili mund të largohet nga juve.

### Asensio dëshiron ta ndjekë rrugën e Ronaldos

